

Prishtinë: 31/05/2007
Kodi i ZRRE-së: D_ 53 _2007

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Kërkesën e KEK SH.A për derogim në zbatimin e Neneve 16.4 dhe 22.1 të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, të datës 21 maj 2007.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në seancën e mbajtur më 31 Maj 2007 ka nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **I lejohet** KEK SH.A. që të kryejë shkyçje komerciale të konsumatorëve edhe jashtë orarit të rregullt të punës, ditëve të pushimit dhe festave, e që lidhen me përdorim të energjisë elektrike sipas Nenit 5 të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë, me këto kushte:

- a) Përfashtimi i zbatimit të Nenit 22.1 të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë lejohet vetëm për gjashtë (6) muaj nga data e miratimi të këtij vendimi,
- b) KEK SH.A. të organizojë shërbimin e faturimit dhe të pagesave gjatë tërë kohës së shkyçjeve komerciale nga Neni 5 i Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë;
- c) KEK SH.A. të kryejë shkyçjet komerciale me kujdes të veçantë, si në paragrafin 1, dhe vetëm në rastet kur nuk ka asnjë dyshim se energjia elektrike është konsumuar sipas Nenit 5 të Rregullit në fjalë.

2. **I lejohet** KEK SH.A. përfashtimi nga implementimi i Nenit 16.4 i cili përcakton rastet e konsumimit të energjisë elektrike sipas Nenit 5 të Rregullit në fjalë dhe nuk do të aplikohet afati kohor minimal prej dhjetë (10) ditësh nga dita e njoftimit për shkyçje deri te shkyçja. Ky përfashtim do të lejohet për gjashtë (6) muaj nga data e nxjerrjes së këtij vendimi.

3. Të gjitha dispozitat tjera të Rregullit mbi Shkyçjen dhe Rikycjen e konsumatorëve në Sektorin e Energjisë në Kosovë do të mbesin në fuqi.
4. **Obligohet** KEK SH.A. që në afat jo më vonë se tre (3) muaj nga data e miratimit të këtij vendimi, t'i propozojë Bordit të ZRRE-së për shqyrtim dhe miratim politikat për shkyçjen dhe rikycjen e konsumatorëve që konsumojnë energjinë elektrike sipas Nenit 5 të këtij Rregulli.
5. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të sundojë versioni në gjuhen shqipe.
6. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh prej miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
7. Ky Vendim hyn në fuqi datën e lëshimit ose datën e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti
Kryesues

Merita Kostari
Anëtare

Theranda Beqiri
Anëtare

Naim Bejtullahu
Anëtar

Nysret Avdiu
Anëtar